

## SPECIFIKIMET TEKNIKE

### ROJA KA PER DETYRE.

- Porten hyrese kryesore te Spitalit Mirdite
- Murin rrethues nga Porta hyres kryesore deri tek pjesa perendimore e Ambulances
- Ambiente e Spitalit Mirdite

1. Ruajtjen e objekteve te caktuara.
2. Kontrollon Flete Hyrjet e Personelit punonjes te Spitalin Mirdite.
3. Ben Kontrollin fizik te personelit civil qe hyne ne Spitalin Mirdite. Kontrollin e kryen se mos kane armatim, paisje te ftota me vete.Nqs i kane paisje te tilla nuk i lejon te futen ne Spitalin Mirdite.
4. Nu lejon persona te futen ne Spitalin Mirdite nga muri rrethues.
5. Ne porten kryesore te Spitalin Mirdite ,lejohen te futen automjetet e Admistrates se Spitalin Mirdite, Ne porten kryesore te Spitalin Mirdite, futen ne cdo kohe automjetet, qe sjellin pacient ne urgjencen e Spitalin Mirdite
6. Paisjen me flete hyrje provizore, kundrejt dokumentit identifikues personelin civil qe vjen per ekzaminime mjekesore ne Spitalin Mirdite
7. Nuk lejon parkimin e Automjeteve ne pjesen perpara urgjences, ne rrugekalimet tek urgjenca
8. Mbrojtjen nga zjarri te objekteve.
9. Cisternen e Solarit.
10. Bombolat e Oksigjenit te Spitalit Mirdite
11. Nuk lejon automjete te huaja te afrohen tek bombolat e oksigjenit,cisternat e karburantit, pervec personelit te Spitalit Mirdite, qe jane te paisur me dokumenta perkatese (Flete Hyrje)
12. Kontrollin per mbylljen dhe vulosjen e objekteve.
13. Kur veren se ne Vr.Nr1, ka shqetesime njofton Pergjegjesin e vete, marrin masa per eliminimin e shqetesimeve.
14. Kryen detyren me patrullim

### Ka ne ruajtje:

- 1.Porten hyrese te Spitalit Mirdite
- 2.Ndertesën Kryesore te Spitalit Mirdite, Polikliniken, ish-Spitalin Infektiv, Laboratorin, Zyrat e Administrates etj sipas inventarit.
- 3.Pjesen ndalimit te automjeteve qe sjellin pacientat ne urgjence

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

Autoriteti Kontraktues	Nr rojeve	Nr vendrojeve	Nr turneve
------------------------	-----------	---------------	------------

<b>Spitali Mirdite</b>			
<i>Vendroja Nr 1 (24 ore)Turn I, II, III</i>	4.7	1	3
<i>Vendroja Nr2.(8 ore) turni 1</i>	1	1	1

### **Sqarim:**

Në ofertë të jenë të përfshira të gjitha shpenzimet e përgjithshme, për uniformat (veshmbathjen), armatim, ndërlydhje (si radiomarrës etj), shpenzimet për pagën e rojeve, shtesat mbi pagën për turnin e dyta (ora 19.ºº - 22ºº), shtesat mbi pagën për turnin e tretë (ora 22.ºº - 06ºº), shtesat mbi pagën për ditët e pushimeve dhe ditët e festave, sigurimet shoqerore dhe shëndetësore si dhe të gjitha detyrimet fiskale që parashikon legjislacioni në fuqi, për 4.7 roje me 1(një) vendroje sipas turneve (shërbim 24 ore). dhe per 1(një) roje per nje vend roje vetem turn i pare.

## **SHËRBIMET DHE GRAFIKU I EKZEKUTIMIT**

### **Sherbimi Privat i Sigurisë Fizike të Spitalit Mirdite”.**

1. Te siguroje dhe te ruaje ambientet ku ushtrohet veprimtaria dhe aktiviteti Spitalit Mirdite nga demtimet, vjedhjet, e mundshme si dhe sigurimin e punes normale te administrates dhe te punonjesve te saj.
2. Rojet duhet të jenë të pajisur me uniformë, sipas legjislacionit në fuqi dhe me karten e identitetit personal per çdo punonjes shërbimi.
3. Punonjesit e shërbimit te jene te pajisur me mjete nderlydhje per komunikim si dhe per parandalimin e ndalimin e veprimtarise se keqberesve ne dem te objektit qe ka nen ruajtje dhe nen pergjegjesine personale te tij.
4. Shërbimi i ruajtjes e sigurimit fizik te objekteve do te jete 24 ore per cdo dite kalendarike, sipas afateve te kontrates.

Pervec shërbimeve te mesiperme, marredheniet me te detajuara midis kontraktuesit dhe Drejtorise se Sherbimit Spitalor Mirdite se do te jepen ne rregulloren e posacme qe do te jete pjese perberese e kontrates.

### **Afatet e ekzekutimit:**

Afati i ekzekutimit do te jete: 25.02.2017 deri me 31.12.2017.

## TERMAT E REFERENCËS

**1. Objekti dhe Qëllimi i Shërbimit:** Objektet e me sipërme do te ruhen nga rojet private te armatosura duke realizuar objektivat dhe detyrat e me poshteme.

Rojet te jene te paisur me arme dhe mjete te tjera mbrojtese, me uniforme te vecante dhe dokumenta qe vertetojne identitetin e tyre. Gjate turneve te dyta dhe te treta rojet te kryejne kontrolle cdo 30 minuta ne te gjitha hapesirat e objekteve

Te ruaj me perkushtim objektin qe i eshte besuar, te ruaj rendin ne to si dhe te siguroje jeten e personelit.

**2. Detyrat:** Roja ka per detyre:

-Te mos lejoje futjen e personave ne objekt pa flete-hyrje.

-Te mos lejoje hyrjen dhe daljen e materialeve pa dokumentin perkates.

-Per persona qe vijne per probleme pune, duhet te njoftoj me pare kerkuesin dhe me lejen e tije e shoqeron tek personi i kerkuar.

-Para marrjes se sherbimit, kontrollon objektin ne prezence te rojes dorezuese dhe per cregullimet e konstatuara njofton pergjegjsin e rojeve dhe ate te objektit, duke bere shenimet perkatese ne librin e sherbimit.

-Te kujdeset per ndricimin e jashtem te objektit duke vene ne dijeni pergjegjesin e tije.

-Ne rast zjarri mer masa per shuarjen e tij dhe menjehere njofton zjarrefikset.

-Te kerkoje nga shtetasit dhe punonjesit te zbatojne rregullat e brendeshme te objektit.

-Kur ne objekt kryhen vepra penale, roja ben bllokimin e mjedisit dhe te autorit,dhe njofton menjehere organet kkompetente.

-Roja perdor armen ne baze te ligjit.

-Roja i objektit per kryerjen e detyrave te tije bashkepunon me policine e rendit.

-Roja per marjen e detyres sipas grafikut duhet te paraqite 15 min para. Atij i ndalohe largimi nga vendi i kryerjes se sherbimit pa u zevendesuar dhe pa mare miratimin e pergjegjesit.

-Ndalohet futja dhe qendrimi i rojes ne ambjentet e brendeshme te objektit perjashtuar rastet per zbatimin e rregullores.

--Roja gjate kohes se sherbimit duhet te karakterizohet nga sjellja qytetare ne komunikim me personat.

-Rojes, gjate kohes se sherbimit i ndalohet te pije pije alkolike, te fleje, te bisedoje me njeres te jashtem.

-Roja duhet te zbatoje vetem urdherat e pergjegjsit te rojeve dhe drejtorave perkates.

-Ndalohet kategorikisht marrja e armatimit me vehte, por ti dorezohet me proces verbal rojes se rradhes.

-Ne vend roje duhet te jene keto dokumenta:

a-Rregullorja e brendshme

b-Libri i marrjes ne dorezim te sherbimit.

c-Grafiku i sherbimit.

d-Inventari i materialeve qe ndodhen ne objekt.

e-Mjete ndricimi ne rast mungese energjije elektrike.

f-Numrat telefonik te rajoneve te policise, zjarrefikseve dhe te personave kryesore pergjegjes te objektit.

g-Skemen e njoftimi ne rast sulmi ose zjarri ne objekt.

h-Listen e automjeteve qe lejohen te hyjne apo te parkohen ne objekt.

-Rojes i ndalohen bisedat telefonike private.

-Roja per probleme urgjente te sherbimit perdor mjetet e nderlidhjes se objektit.

-Ndalohet nderrimi i grafikut te sherbimit pa miratimin e pergjegjesit te rrojeve.

-Cdo levizje e personelit apo personave te tjere, shenohet ne librin e sherbimit te rrojes.

**3. Shpërndarja:** Te behet sipas objekteve dhe turneve te siperpermendura, per te siguruar mbulimin e tyre me sherbimin e rojeve pa nderprerje gjate gjithë vitit kalendarik.

**4. Vendi i kryerjes së Shërbimit:** Spitali Mirditë, Rrëshen